



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2020

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7895,**  
**DATË 27.1.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Pas nenit 154 shtohet neni 154/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 154/a

Shkatërrimi i ndërtesave dhe objekteve të tjera

Kryerja e çdo veprimi tjetër me dashje, të ndryshëm nga ato të parashikuar në nenet e mësipërme, që mund të sjellë rrëzimin e plotë ose të pjesshëm të ndërtesave, objekteve qytetare, veprave industriale, të infrastrukturës ose të çdo objekti tjetër që mund të rrezikojë jetën ose shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.”.

## **Neni 2**

Në nenin 199/a bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalët “... në shkelje të rëndë të lejes ...” hiqen.
2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Po kjo vepër, e kryer për plotësimin e nevojave për strehim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) muaj.”.

## **Neni 3**

Pas nenit 199/b shtohet neni 199/c, me këtë përmbajtje:

“Neni 199/c

Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i paligjshëm i ndërtimeve

Projektimi, mbikëqyrja, zbatimi ose kolaudimi i punimeve të ndërtimit në kundërshtim me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit nga persona ndaj të cilëve janë marrë më parë masa administrative për këto shkelje dënohet me burgim nga 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet.

Nxitja, me ose pa shpërblim, ose detyrimi i projektuesit, mbikëqyrësit, zbatuesit ose kolauduesit të punimeve të ndërtimit për të shkelur rregullat që garantojnë kryerjen e ndërtimeve në përputhje me ligjin, dokumentet e planifikimit, standardet profesionale në fuqi ose në kundërshtim me lejen e zhvillimit ose të ndërtimit, sipas paragrafit të parë të këtij neni, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga 1 (një) deri në 5 (pesë) vjet.

Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) vjet.

Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.”.

## **Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**